

Thirrja është e hapur nga data 23.04.2024 deri më 07.05.2024

## TERMAT E REFERENCËS

### FURNIZIMI ME VETURË

<b>Organizata</b>	<b>OJQ "NEVO KONCEPTI"</b>
<b>Objektiva</b>	<b>Furnizimi me një (1) veturë</b>

#### 1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Rom të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

#### 2. RRETH PROJEKTIT

Aktualisht, "Nevo Koncepti" është pjesë e konsorciumit të përbërë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Karl Kuebel Stiftung (KKS), dhe Drejtësi Sociale (DS). Ky konsorcium ka filluar zbatimin e projektit "Promovimi dhe Realizimi i të Drejtave të Romëve në Kosovë dhe në Shqipëri". Projekti përkrahët dhe financohet nga *Ministria për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim e Republikës Gjermane (BMZ), Karl Kuebel Stiftung (KKS) dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS)*. Grupi i synuar në Kosovë janë pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shtatë komunat më të mëdha të Kosovës. Ndërkaq, fokusi i projektit do të jetë në katër fusha: Arsim, Punësim, Shëndetësi dhe Hartim Politikash.

#### 3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Kompletimi i dokumentacionit sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për ofertë.
- Ofertimi për furnizim me një (1) veturë, me specifika teknike minimale si më poshtë:
  1. Veturë e re – 00.00 km
  2. Vëllimi i motorit - Minimum 1197 cc
  3. Fuqia – minimum 75 Kw
  4. Tërheqja me rrota para
  5. Ndërruesi manual ose automatik – minimum me 6 shpejtësi
  6. Dyer – 5
  7. Airbag për shoferin

8. Mbyllje qendrore nga distanca
9. Pasqyret me rregullim elektrik
10. Radio USB me komanda në timon
11. Klima manual AC
12. Drita ditore LED
13. Garancioni minimum 24 muaj
14. Shitje dhe servisim i autorizuar në Kosovë
15. Shpenzimet e kombinuara te vozitjes – minimum 5.2 L

#### **4. AFATI KOHOR**

- Thirrja për ofertë është e hapur nga data **23.04.2024 deri më 07.05.2024**

#### **5. VLERA E PARASHIKUAR E KONTRATËS**

- 20,000 €, pa TVSH

#### **6. ÇMIMI**

- Çmimet duhet të jepen në euro, duke përjashtuar TVSH-në.

#### **7. VLEFSHMËRIA E OFERTËS**

- 90 ditë nga dita e përmbylljes së thirrjes për ofertim.

#### **8. VLERËSIMI I OFERTAVE**

- Do të vlerësohen ofertat e përcaktuara si thelbësisht përgjegjëse ndaj specifikimeve teknike.
- Do të zgjidhet kompania e cila ofron ofertën e vlerësuar si ekonomiksht më e favorshme dhe produktet e së cilës përmbushin standardet e kërkesave teknike.

#### **9. KRITERET E VLERËSIMIT**

- Çmimi – max. 40 pikë
- Specifikimet teknike – max. 30 pikë
- Garancioni – max. 15 pikë
- Koha e furnizimit me veturë – max. 15 pikë

#### **10. REZULTATET E PRITSHME**

- Bashkëpunim i mirë në mes të furnitorit dhe kontraktuesit.
- Ofertimi sipas specifikimeve të kërkuara.
- Përmbushja e afateve kohore të furnizimit.

#### **11. PROCEDURA E APLIKIMIT**

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

1. Kopja e regjistrimit të biznesit në ARBK me numër unik identifikues.
2. Informatat mbi biznesin.

3. Specifikimet teknike të veturave.
4. Fotografi të veturave.
5. Garancioni i veturave të ofruara.
6. Afati kohor i dorëzimit të veturës (Ofertuesit duhet të tregojnë çartë kohën e nevojshme që iu nevojitet për dorëzimin e veturës dhe dorëzimin në destinacionin final nga vetë kompania).
7. Oferta e nënshkruar dhe e vulosur në secilën faqe.
8. Periudhën e vlefshmërisë së ofertës.

## **12. MËNYRA E DORËZIMIT**

Ofertat duhet të dorëzohen jo më larg se me datë **07.05.2023**, në ora **16:30**, në formë elektronike apo fizike (kopja fizike duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur dhe të vulosur):

- Në adresën elektronike: [anesaberisha@nevokoncepti.org](mailto:anesaberisha@nevokoncepti.org), ku në cc duhet të jetë [o.osmani@nevokoncepti.org](mailto:o.osmani@nevokoncepti.org).
- Në zyrën e Nevo Konceptit, me adresë: Rr. "Adnan Krasniqi", nr.149, hyrja II/18, 20000, Prizren.

**Për çdo pyetje shtesë rreth kësaj ftese për ofertë mund të na shkruani në email-in: [anesaberisha@nevokoncepti.org](mailto:anesaberisha@nevokoncepti.org)**